



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo  
Komuna - Municipality  
Hani i Elezit



01/Nr.3718/2020

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 40, Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike 03/L-048 neni 45.4, Statutin e Komunës së Hanit të Elezit neni 64, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 14.07.2020 merr:

**VENDIM**

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË SHPENZIMEVE BUXHETORE PËR PERIUdhËN  
JANAR-QERSHOR PËR VITIN 2020**

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për raportin e shpenzimeve buxhetore për periudhën Janar -Qershor për vitin 2020.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është raporti i shpenzimeve buxhetore për periudhën Janar- Qershor 2020 i hartuar nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa. Buxheti i miratuar për vitin fiskal 2020 është në shumë prej 2,742,095.00 €, ndërsa buxheti përfundimtar është në shumë prej 2,939,154.51 €. Në kategorinë paga dhe mëditje shpenzimi është në shumë prej 768,907.83 € ose 50.02% në kategorinë mallra dhe shërbime shpenzimi është në shumë prej 126,562.94 € apo 38.45%, në kategorinë ekonomike shpenzime komunale shpenzimi është në shumë prej 22,500.10 € apo 37.50% në kategorinë ekonomike subvencione dhe transfere shpenzimi është në shumë prej 34,300.00 € apo 42.22% në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale kemi shpenzuar 115,914.83 € apo 15.20% . Totali i shpenzimit për periudhën Janar - Qershor të vitit 2020 është në shumë prej 1,068,185.70 € apo 36.34%. Të hyrat vetanake për këtë periudhë gjashtëmujore 2020 janë realizuar në shumë prej 127,951,20 € apo 40.25 %.
3. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit  
Data: 14.07.2020





Republika e Kosovës / Republic of Kosova  
Komuna - Municipality  
Hani i Elezit



01/Nr. 4237 /2020

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 40, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 14.07.2020 merr:

**V E N D I M**  
**PËR THEMELIMIN E GRUPIT PUNUES PËR HARTIMIN E PLANIT TË PUNËS SË KUVENDIT PËR VITIN 2021**

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për themelimin e grupit punues për hartimin e planit të punës së kuvendit të komunës për vitin 2021.

2. Grupit punues për hartimin e planit të punës së kuvendit përbehet prej 7 (shtatë) anëtarëve dhe i njëjti do të ketë këtë përbërje:

1. Qamush Brava - AAK
2. Nora Xhoni - AAK
3. Teuta Shkreta - VV
4. Sabedin Hasallari - LDK
5. Mehmet Ballazhi - PDK
6. Mefail Suma - NISMA
7. Sead Vila - I PAVARUR

3. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Anëtarët e grupit punues,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit  
Data: 14.07.2020

Kryesuesi i Kuvendit  
MSc. Qamush Brava

